

# Investimet e BEI-së në kujdesin shëndetësor në Ballkanin Perëndimor: Vështrim i përgjithshëm



## BEI NË BALLKANIN PERËNDIMOR - TË DHËNAT KYÇE

Mbi  
**8** miliardë  
euro

## TË INVESTUARA MIDIS 2008 DHE 2019

- **365 milionë euro** të investuara në kujdesin shëndetësor
- Kujdes shëndetësor të përmirësuar për mbi **5 milionë qytetarë**
- **20 spitale** dhe **5 qendra klinike** të rinovuara dhe pajisura
- Mbi **1 000 shtretër të rinj spitalorë**
- Paketë mbështetëse e BEI-së me një vlerë **1,7 miliardë euro** për Ballkanin Perëndimor për **rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike nga COVID-19**, pjesë e paketës së mbështetjes për rajonin me vlerë prej **3,3 miliardë euro**, të dhënë nga Komisioni Evropian.



## KUJDES SHËNDETËSOR MODERN, TË QËNDRUESHËM DHE EFIKAS

Banka Evropiane e Investimeve mbështet vendet e Ballkanit Perëndimor në zhvillimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe të cilësisë së lartë të kujdesit shëndetësor. Ajo ka investuar 365 milionë euro në projektet e kujdesit shëndetësor në rajon që prej vitit 2008.

BEI-ja mbështet rajonin me kredi të përballueshme dhe afatgjata, shpeshherë të kombinuara me instrumente të tjera financiare dhe grante të BE-së për të maksimizuar ndikimin e tyre. Banka gjithashtu ofron asistencë teknike këshillimore, duke i ndihmuar klientët në mbarë rajonin që të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte të besueshme në sektorin e kujdesit shëndetësor.

BEI-ja mbetet e angazhuar ndaj Ballkanit Perëndimor në situatën e COVID-19. Modernizimi dhe përmirësimi i sektorit të kujdesit shëndetësor publik në Ballkanin Perëndimor; transformimi i tij në një sistem të integruar dhe të qëndrueshëm, me infrastrukturë të përmirësuar dhe cilësi kujdesi, dhe një model optimal financimi; dhe financimi i projekteve të kujdesit shëndetësor që promovojnë barazinë e qasjes - të gjitha këto janë prioritete të rëndësishme të BEI-së.

## FAKTET KRYESORE PËR PROJEKTET NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

**Serbi: 200 milionë euro të investuara në modernizimin, rizhvillimin dhe shtrirjen e shërbimeve spitalore tretësore të Serbisë, të siguruara nga Qendrat Klinike në Beograd, Nish, Novi Sad dhe Kragujevac.** Qendra Klinike në Nish, e rindërtuar me këtë kredi, ka zgjeruar kapacitetin e saj në afërsisht 45 000 m<sup>2</sup> dhe ka shtuar 600 shtretër spitalorë. Mbi 2,5 milionë qytetarë në Serbi kanë qasje në shërbimet moderne të kujdesit shëndetësor në këtë objekt, i cili është transformuar në një qendër të madhe mjekësore në rajon dhe një institucion thelbësor për Serbinë në përpjekje për të përballuar pandeminë e COVID-19.



**Serbi: 50 milionë euro të investuara në rehabilitimin e 20 spitaleve rajonale, dy qendrave klinike dhe dy instituteve, duke përfshirë Institutin e Virologjisë, Vaksinave dhe Serumeve** "Torlak", ku BEI-ja ka ofruar mbështetje në modernizim e prodhimit të vaksinave në një vlerë prej 3,6 milionë euro. "Torlak" është tashmë një nga institucionet kryesore në luftën kundër COVID-19 në Serbi. Ky investim mundësoi rindërtimin e infrastrukturës dhe zëvendësimin e pajisjeve mjekësore dhe jo-mjekësore, duke përfshirë ambientet e kuzhinës dhe të larjes, gjeneratorët dhe ambulancat.

**Bosnjë dhe Hercegovinë: 115 milionë euro të investuara në rindërtimin e Qendrës Klinike në Banja Luka. Departamenti i kirurgjisë, ai intensiv, i emergjencës dhe ambulator janë rinovuar dhe plotësuar me pajisje.** Projekti gjithashtu ka forcuar kapacitetet e arsimit të klinikës universitare, duke ofruar kushte më të mira mësimdhënieje për profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe studentët. Së fundmi, investimi i BEI-së ka mundësuar ndërtimin e një spitali të ri me sipërfaqe 16.000 m<sup>2</sup> në Bijeljina.

**Asistenca teknike: BEI-ja ka ndihmuar nismëtarët në Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë<sup>1</sup>** me aplikimet e tyre për grante në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) dhe ka mbështetur zbatimin e tyre. Asistenca teknike është faktor kyç për sistemet e kujdesit shëndetësor, pasi ajo ndihmon në forcimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre.

## **LISTA E PROJEKTEVE**

Ka shumë projekte të sektorit shëndetësor në listë dhe në fazë vlerësimi. Këto mund të përfshijnë shpenzime shtesë për një total financimi prej 424,5 milionë euro në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Mal të Zi.

**“Përkundër sfidave të mëdha të krijuara nga kriza e COVID-19 brenda vetë BE-së, Unioni ka treguar mbështetjen e tij të palëkundur për vendet e saj partnere dhe angazhimin e tij për bashkëpunim dhe koordinim ndërkombëtar. Nevojat e mëdha në rajon mund të adresohen vetëm nga një përpjekje me padurim të kontribuojë në Kornizën e Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe Planin e ardhshëm Ekonomik dhe të Investimeve për Rimëkëmbjen”.**

**Werner Hoyer, President, BEI.**

1. Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve të shprehura nga Shtetet Anëtare të BE-së mbi statusin e Kosovës dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



### Banka Evropiane e Investimeve

98-100, boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

☎ +352 4379-1

[www.eib.org](http://www.eib.org) – ✉ [info@eib.org](mailto:info@eib.org)

🐦 [twitter.com/EIB](https://twitter.com/EIB)

📘 [facebook.com/EuropeanInvestmentBank](https://facebook.com/EuropeanInvestmentBank)

📺 [youtube.com/EIBtheEUbank](https://youtube.com/EIBtheEUbank)

### [www.eib.org/western-balkans](http://www.eib.org/western-balkans)

#### Miguel Morgado

Drejtor, Operacionet e Kredidhënies

Departamenti për Detin Adriatik

☎ +352 4379-86446

✉ [m.morgado@eib.org](mailto:m.morgado@eib.org)

#### Matteo Rivellini

Shefe e Divizionit, Operacionet e Kredidhënies

Ballkani Perëndimor, Slloveni dhe Kroaci

☎ +352 4379-88417

✉ [m.rivellini@eib.org](mailto:m.rivellini@eib.org)

#### Marco Santarelli

Kontakti me shtypin, Zyrtar i lartë për shtypin

☎ +39 064 719 1

✉ [m.santarelli@eib.org](mailto:m.santarelli@eib.org)

#### Gordana Kovačević

Pika kontakti për shtypin:

☎ +352 4379-70356

✉ [g.kovacevic@ext.eib.org](mailto:g.kovacevic@ext.eib.org)

#### Dubravka Nègre

Përgjegjëse e Përfaqësisë Rajonale të BEI-së për Ballkanin Perëndimor,

Përfaqësia Rajonale për Ballkanin Perëndimor

Vladimira Popovića 38-40

11070 Beograd

☎ +381 113 121 756

✉ [d.negre@eib.org](mailto:d.negre@eib.org)

#### Sandrine Friscia

Përfaqësues i BEI-së për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi

Delegacioni i Bashkimit Evropian në BH, Skenderija 3a

71000, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë

☎ +387 33 254 792

✉ [s.friscia@eib.org](mailto:s.friscia@eib.org)

#### Alessandro Bragonzi

Përfaqësues i BEI-së për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën\*

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

ABA Business Centre, kati 17

Rruga Papa Gjon Pali II

Tiranë, Shqipëri

☎ +352 4379-83066

✉ [a.bragonzi@eib.org](mailto:a.bragonzi@eib.org)

<sup>[\*]</sup> Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës